



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 621 prot.

Tiranë, më 27. 05. 2020

Lënda: Rekomandime mbi projektligjin “*Për Shtetësinë*”.

## KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

KUVENDI I SHQIPËRISË

TIRANË

Të nderuar,

Në vijim të komunikimit elektronik dhe pas konsultimit të projektligjit “*Për Shtetësinë*” dhe Relacionit shoqëruesh, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parashtron mendime, brenda fushës së veprimtarisë dhe mandatit të tij, si më poshtë vijon:

Paraprakisht, ju bëjmë me dije se Komisioneri ka patur mundësi të njihet dhe të japë rekomandime lidhur me projektligjin “*Për shtetësinë*”, me kërkesë të Ministrisë së Brendshme, nga ku rezulton se janë marrë parasysh pjesërisht.

Duke vlerësuar reflektimin ne draftin e Ministrisë së Brendshme të disa prej rekomandimeve tonë, risjellim në vëmendje të Kuvendit se interes i Komisionerit për këtë projektligj mbetet mbi propozimet e mëposhtme:

### I) *Përfshirja e parimit të mosdiskriminimit*

Në variantin e parë të rekomandimeve dërguar Ministrisë së Brendshme, Komisioneri ka propozuar përfshirjen e një parashikimi ligor mbi parimin e mosdiskriminimit, i cili nuk ekziston në ligjin aktual, sipas kësaj përbajtje:

*“Rregullat mbi fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare nuk duhet të përbajnë dallime apo të përfshijnë ndonjë praktikë, e cila rezulton në diskriminimin mbi bazën e seksit, besimit, racës, ngjyrës ose origjinës kombëtare apo etnike, ose çdo shkak tjetër të parashikuar në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.”*

Rezulton se, në krahasim me variantin e mësipërm, ky parim është parashikuar, në projektligjin e sjellë rishtazi për shqyrtim nga ana juaj, por në pjesën e parimeve, me përmbajtje:

*“Zbatimi i dispozitave të këtij ligji për fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare bazohet në parimet e mëposhtme:*

*ç) Mosdiskriminimi ndërmjet shtetasve shqiptarë, pavarësisht nëse ata janë shtetas që nga lindja apo e kanë fituar shtetësinë shqiptare sipas këtij ligji.”*

Sa më lart, konstatojmë se parimi i mosdiskriminimit është reflektuar, por përcaktimi në projektligjin e sjellë rishtazi për mendim nga Kuvendi, se parimi i mosdiskriminimit *zbatohet ndërmjet shtetasve shqiptare, pavarësisht nëse ata janë shtetas që nga lindja apo e kanë fituar shtetësinë shqiptare sipas këtij ligji* nuk qëndron përsa i përket rregullave për fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë.

Referuar Konventës Europiane “Për Shtetësinë”<sup>1</sup>, Komisioneri në propozimet e tij sjell në vëmendje se janë dy situata të ndryshme në të cilat vepron parimi i mosdiskriminimit:

- *Së pari*, në rregullat mbi shtetësinë, ku kërkohet që ato të mos përmbajnë dallime apo të përfshijnë ndonjë praktike, e cila rezulton ne diskriminim dhe
- *Së dyti*, në trajtimin e shtetasve shqiptare, pavarësisht mënyrës së fitimit të shtetësisë.

***Rekomandojmë, riformulimin e nenin 3, germa (ç) dhe shtimin e pikës 2 në këtë nen, të projektligjit “Për Shtetësinë”,*** me përmbajtje:

***“1. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji për fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare bazohet në parimet e mëposhtme:***

*ç) Rregullat mbi fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare nuk duhet të përmbajnë dallime apo të përfshijnë ndonjë praktikë, e cila rezulton në diskriminimin mbi bazën e seksit, besimit, racës, ngjyrës ose origjinës kombëtare apo etnike, ose çdo shkak tjetër të parashikuar në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.*

***2. Ndërmjet shtetasve shqiptare zbatohet parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, pavarësisht nëse ata janë shtetas që nga lindja apo e kanë fituar shtetësinë shqiptare sipas këtij ligji.”***

Vlerësojmë si të rëndësishëm marrjen parasysh të këtij Rekomandimi të Komisionerit duke përfshirë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, në harmoni me Konventën Evropiane “Për Shtetësinë”, dhe me legjislacionin e brendshëm shqiptar.

Nëpërmjet këtij rekomandimi, Komisioneri vlerëson se do të garantohet:

<sup>1</sup> Neni 5, Mosdiskriminimi:

*“1. Rregullat e një Shteti Pale mbi shtetësinë nuk do te përmbajnë dallime apo te përfshijnë ndonjë praktike, e cila rezulton ne diskriminimin mbi bazën e seksit, besimit, racës, ngjyrës ose origjinës kombëtare apo etnike.*

*2. Çdo Shtet Pale do te udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit ndërmjet shtetasve te tij, pavarësisht nëse ata janë shtetas nga lindja apo e kane fituar shtetësinë me pas.”*

- një harmonizim më i plotë i këtij ligji me legjislacionin europian, konkretisht me Konventën Europiane “Për shtetësinë”, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8942, datë 19.9.2002;
- që çdo rregull, mbi fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare, të hartohej në përputhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit si dhe të zbatohet në praktikë, sipas këtyre parimeve.
- zgjerimi i listës së shkaqeve të mbrojtura të diskriminimit, duke parashikuar një listë të hapur të shkaqeve përfshirë cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, konkretisht nëpërmjet vendosjes së shprehjes “*çdo shkak tjetër ..*”. Kjo garanton më shumë mbrojtje përfshirë cilët, përfshirë shkak të karakteristikave të veçanta të tyre, mund të bëhen viktima të pabarazisë dhe diskriminimit.

## **II) Efektet në shtetësinë shqiptare në rastet e martesës**

Në variantin e parë të rekomandimeve dërguar Ministritës së Brendshme, Komisioneri ka propozuar përfshirjen e një parashikimi ligjor, me përbajtje:

*“As martesa dhe as zgjidhja e një martese ndërmjet një shtetasi shqiptar dhe një te huaji, si dhe as ndryshimi i shtetësisë nga njeri prej bashkëshorteve gjatë martesës nuk do të ndikojë automatikisht shtetësinë e bashkëshortit tjetër.”*

Nëpërmjet këtij rekomandimi, Komisioneri vlerëson se do të garantohet:

- një harmonizim më i plotë i këtij ligji me legjislacionin europian, konkretisht me Konventën Europiane “Për shtetësinë”, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8942, datë 19.9.2002.

Në kushtet kur, konstatuam se ky parashikim eksplicit nuk është përfshirë në projektligjin “Për Shtetësinë”, e risjellim edhe njëherë në vëmendjen tuaj. Për këtë arsyen:

*Rekomandojmë, përfshirjen e këtij parashikimi ligjor, në nenin 3, me përbajtje:*

*“As martesa dhe as zgjidhja e një martese ndërmjet një shtetasi shqiptar dhe një te huaji, si dhe as ndryshimi i shtetësisë nga njeri prej bashkëshorteve gjatë martesës nuk do të ndikojë automatikisht shtetësinë e bashkëshortit tjetër.”*

**Duke Ju falenderuar përfshirjen e këtij parashikimi ligjor, në nenin 3, me përbajtje:**



